Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e ***anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik***, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP¹.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomiksi më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shtojca 7/1

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimin dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Nërastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formulari i Ofertës sipas Shtojces 1,*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur Shtojca 1/1*
- c. *Deklarate mbi permbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojces 5;*
- ç. *Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojces 6*
- d. *Deklaratë mbi përmbushjen e Kriteve të Përgjithshme sipas Shtojces 7;*
- e. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 7/1:*
- f. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor);

2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë

- 2.1.1 Licensë e shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike” e vlefshme, miratuar me vendim të DPP se shtetit për nënkategorin 1.3.A, me veprimtari “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKL;
- 2.1.2 Çertifikatë e drejtuesit teknik dhe titullarit të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A;
- 2.1.3 Çertifikatë për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave sipas Ligjit 75/2014 të lëshuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan për të paktën 35 (tridhjetë e pesë);

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Xhiroja mesatare vjetore gjatë dy viteve (2017,2018) të ketë një vlerë sa 27% i Marrëveshjes Kuader.Kopje të çertifikuara të bilanceve të dy viteve (2017,2018).Për xhiron operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë dy viteve (2017,2018).

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1 Dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 40% vlerës së fondit të Marrveshjes Kuader, të kryera gjatë tre viteve të fundit.
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara gjatë tre viteve të fundit.
 - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- 2.3.2 Autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi, konform Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Per komunikimin elektronike në RSh” me zonë mbulimi qyteti Elbasan.
- 2.3.3 Operatori ofertues duhet të paraqesë Aktin e Miratimit të Qendrës së Kontrollit, miratuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan konform Udhezimit të Ministrit të Brendshëm nr.130, datë 05.03.2018 ”Per funksionimin e shërbimit privat të sigurisë.
- 2.3.4 Operatori ofertues duhet të paraqesë vërtetim për performancë nga Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan me afat një muaj nga hapja e ofertave, në të cilën të pasqyrohet informacioni për: -Lista emërore e punonjësve të certifikuar nënkategoria 1.3.A për jo më pak se 35 (tridhjetë e pesë) punonjës shërbimi; -Të ketë qender kontrolli me operator dhe grup të gatshëm 24 orë; - Të mosë ketë marrë masë administrative nga policia e shtetit për Subjektin, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik për vitin 2018-2019 (*të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të*); -Të ketë jo më pak se numri i vendrojeve të kërkuara pajime: shkop gome, hekura lidhës, armë brezi, radio komunikimi, si dhe të jap informacion për numrin autorizim mbajtje arme, minimalisht njëzetëtre sa numri i punonjësve shërbimit për turnin e dytë dhe të tretë;
- 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit që përkojnë sipas legjislacionit tatimor me hapjen e tenderit, të shoqëruar me listëpagesat kontributeve të sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025/a) për këtë periudhë. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht 37 (tridhjetë e shtatë) të siguruar në muaj, 35 (tridhjetë e pesë) punonjës shërbimi roje, si dhe drejtuesin teknik dhe administratorin.
- 2.3.4 Operatori ekonomik të disponojë automjete në emër të shoqërisë në pronësi apo të marra me qira, jo më pak se një automjete dhe një motociklet për lëvizje më të shpejtë për verifikimin e sinjaleve të alarmit.
- Leje e Qarkullimit, drejtimi dhe taksat e automjetit në pronësi të shoqërisë.
- Në rastin kur automjeti është marrë me qera, Leja e Qarkullimit duhet të shoqërohet edhe me Kontratën noteriale të marrjes me qera, ku të jetë përcaktuar afati dhe qëllimi i marrjes me qera.
- 2.3.6 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur. **(Shih Shtojca 1 - Sqarime)**

Operatori ekonomik duhet të nënshkruajë dhe vulos specifikimet teknike, shërbimin dhe grafikun e ekzekutimit dhe termat e references.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknike etj:

Shërbimi që kërkohet Objekti: “Shërbimi i ruajtjes me roje dhe sistem alarmi” Qendres Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

A. Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise me roje me nga nje vend roje me tre turne 24 orë per cdo ditë kalendarike te spitaleve;

-Spitali Elbasan (Pathollogji) 1 vendroje, -Spitali Elbasan (Kirurgji-Maternitet) 1 vendroje, Poliklinika e Specialiteteve 1 vendroje, -Spitali Elbasan (Pediatria) 1 vendroje, -Spitali Elbasan (Urgjenca) 1 vendroje, -Spitali Elbasan godina adm 1 vendroje, -Spitali Elbasan (Telemjeksisa) 1 vendroje;

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Sherbimi i Ruajtjes dhe i Sigurise kerkohet te kryhet per spitalet sipas vendndodhjes me punonjes sherbimi me tre turne dhe per objektet me sinjal alarmi, shoqeria te marre persiper ruajtjen, parandalimin e vjedhjeve, demtimeve te materialeve.
2. Sherbimi te kryhet ne zbatim ne Ligjet 75/2014, 74/2014 si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre me armatim, uniforme, paisje nderlidhje dhe mjet transporti. Sherbimi ne objekte te behet me plan dislokimi dhe skemen e ruajtjes se objekteve sipas shtrirjes se tyre. Ne cdo vedsherbim te kete liber sherbimi per marrjen dhe dorezimin e detyres me instruktazhin e nevojshem nga pergjegjesi i sherbimit/Drejtuesi Teknik i Shoqerise.
3. Punonjesit e sherbimit te jene te çertifikuar konforme Ligjit 75/2014, gjate ushtrimit detyres punonjesi te jete i pajisur me uniformen, shenjen dalluese, emblemen, stemen e shoqerise, dokumentin identifikues si dhe pajimet personale si shkop gome, hekura lidhes, rrip multifunksional, konform Udhezimit te MB nr.130, date 05.03.2018 ”Per funksionimin e Shpsf”.
4. Te kete Qendren e kontrollit me punonjes shërbimi operator dhe grupe te gatshme 24 ore per verifikimin e sinjaleve te alarmit dhe menaxhimin e sherbimeve. Grupi i sherbimit te jete i pajisur me uniform, armatim me autorizimin e perdorimit arme, nderlidhje, automjete me

Dokumentat Standarde të Tenderit

stemen e shoqerise si dhe pajisje te tjera speciale per nderhyrje ne raste te ngjarjeve.

5. Çdo vendsherbim te jete i pajisur me: - nje arme brezi dhe me lejet e perdorimit ne vendsherbim; - nje radio-komunikimi dore, hekura lidhes, shkop gome si dhe pajime te tjera te cilet perdoren nga cdo punonjes sherbimi sipas turnit perkates.
6. Te mbuloje te gjitha shpenzimet si detyrimet fiskale, paga e rojeve , sigurimet shoqerore te personelit te punesuar nga ana e tij per ruajtjen e objekteve , shpenzimet per uniformat, armatime, nderlidhje si dhe gjithë kompesimet e tjera te njohura me ligj.
7. Kontraktori mban pergjegjesi per demtimet apo vjedhjet qe mund te ndodhin ne objekte qe ruhet nga ana e tij, kur keto vijne si rezultat i moskryerjes me korektesi te sherbimit apo mungeses se vigjilences te rojeve, dhe qe vertetohet nga organet kompetente. Ne kete rast kontraktori detyrohet te beje çdemtimin 100% te vleres se demtuar.

Detyrat e punonjesit sherbimit:

- Punonjësi i shërbimit do të kryej shërbim sipas planizimit të shërbimit në libërin e sherbimit dhe instruktazhin e nevojshëm nga pergjegjesi i sherbimit/Drejtuesi Teknik i Shoqërisë.
- Punonjesi i sherbimit gjate kryerjes detyres te jete i pajisur me uniformen, shenjen dalluese, emblemen, stemen e shoqerise, dokumentin identifikues si dhe pajimet personale si shkop gome, hekura lidhes, rrip multifunksional etj konforme akteve ligjore.
- Punonjësi i shërbimit të mbajë, sipas rregullores, armatimin personal ne detyrë të miratuar nga Policia Shtetit, si dhe të përdorë armën sipas legjislacionit në fuqi;
- Punonjësi i shërbimit të komunikojë me transparencë, etikë dhe konform kërkesave të ligjit me qytetarët, eprorët dhe me çdo autoritet ligjzbatues, kur kërkohet një gjë e tillë;
- Gjate turneve te dyta dhe te treta rojet te kryejne kontrolle çdo 15 minuta ne te gjitha hapesirat e objekteve.
- Te ruaje me perkushtim objektin qe i eshte besuar, te ruaje rendin ne to si dhe te siguroje jeten e personelit.
- Te mos lejoje futjen e personave ne objekt pa flete-hyrje.
- Te mos lejoje hyrjen dhe daljen e materiale pa dokumentin perkates.
- Per persona qe vijne per probleme pune, duhet te njoftoje me pare kerkuesin dhe me lejen e tij i shoqeron tek personi i kerkuar.
- Para marrjes se sherbimit, kontrollon objektin ne prezence te rojes dorezuese dhe per çrregullimet e konstatuara njofton pergjegjesin e rojeve, duke bere shenimet perkatese ne librin e sherbimit.
- Te kujdeset per ndriçimin e jashtem te objektit duke vene ne dijeni pergjegjesin e tij.
- Ne rast zjarri merr masa per shuarjen e tij dhe menjehere njofton zjarrfikseset.
- Te kerkoje nga shtetasit dhe punonjesit te zbatojne rregullat e brendshme te institucionit.

B. Objekte te Qendres Spitalore qe do te ruhen me sistemi elektronik (sinjal alarmi)

Nr	Emertimi i Objekteve	
----	----------------------	--

Dokumentat Standarde të Tenderit

.	ku do te ruhen me perdorim te sistemi elektronike	Sistem alarmi
1	<u>Farmacia e Spitalit;</u> Sherbim i ruajtjes me sinjal alarmi te funksionojë sipas orareve: 16. ⁰⁰ -08. ⁰⁰ (e Hene - e Shtune) dhe ne raste orgjencash do te hapet dhe mbyllet sipas kerkeses AK-se , (e diele, ditet e festave) 24 ore	1 sistem alarmi me aksesoret perkates ndihmes
2	<u>Ambjenti i Vendqendrimi te Autoambulancave ;</u> Sherbim i ruajtjes me sinjal alarmi te funksionojë sipas orareve turneve, si dhe ne raste orgjencash do te hapet dhe mbyllet sipas kerkeses AK-se.	1 sistem alarmi me aksesoret perkates ndihmes
3	<u>Godina e Radiologjisë;</u> Sherbim i ruajtjes me sinjal alarmi te funksionojë sipas orareve: 16. ⁰⁰ -08. ⁰⁰ (e Hene-e premte) dhe ne raste orgjencash do te hapet dhe mbyllet sipas kerkeses AK-se , (e shtune e diele, ditet e festave 24 ore)	1 sistem alarmi me aksesoret perkates ndihmes
4	<u>Objekti me hyrje nga mbrapa Poliklinikës ;</u> Sherbim i ruajtjes me sinjal alarmi te funksionojë sipas orareve: 16. ⁰⁰ -08. ⁰⁰ e Hene-e premte dhe (e shtune e diele, ditet e festave 24 ore)	1 sistem alarmi me aksesoret perkates ndihmes
5	<u>Magazina e Farmacisë;</u> Sherbim i ruajtjes me sinjal alarmi te funksionojë sipas orareve: 16. ⁰⁰ -08. ⁰⁰ (e Hene-e premte) dhe ne raste orgjencash do te hapet dhe mbyllet sipas kerkeses AK-se , (e shtune e diele, ditet e festave 24 ore)	1 sistem alarmi me aksesoret perkates ndihmes
	Shuma	5 sisteme

Sistemet e Alarmit funksionojne sipas orareve te parashikuara:

1. Sistemi të realizohet në mënyrë të integruar për të gjitha shërbimet (sistem alarmi, GPS) në mënyrë që të bëjë sa më të lehtë dhe më fleksibël monitorimin nga operatorët e qendres kontrollit.
2. Sistemet e Alarmit janë Sisteme teknologjike elektronike moderne për sinjalizimin e hyrjes apo demtimeve të paligjshme në ambientin e marre në sigurim.
3. Përgjegjësit e objekteve garantojnë aktivizimin dhe caktivizimin e alarmit në momentin e mbylljes dhe hapjes së objektit.
4. Shoqëria e sigurisë mban përgjegjësi pas aktivizimit të sistemit të alarmit në rast se vjedhja apo demtimi i materialeve në objektin e siguruar ka ardhur si pasoje e neglizhencës së shërbimeve të kësaj shoqërie (pas ardhjes së sinjalit të alarmit në monitor si pasoje e mosvlerësimit dhe vonësës në verifikim).
5. Montimi dhe mirembajtja e pajisjeve të sistemit të alarmit janë përgjegjësi e shoqërisë private të sigurisë.
6. Sistemet e Alarmit të jenë me transmetim me GPRS, me sistem mbyllje me pult ose me tastier me kod, me sensore me kabell ose me ëireless.
7. Të gjitha shpenzimet e mirëmbajtjes, për pjesë ndërrimi, paisjet e zëvendësuar, zëvendësimin e baterive, sensorë të ndryshëm, DVR, Centrale të sistemeve të alarmit, kabëll rrjeti etj, gjatë procesit të shërbimit do të mbulohen nga vetë shoqëria e sigurimit për gjithë kohën e parashikuar në kontratë midis palëve.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Shërbim: Mall: Punë: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Shërbimi që kërkohet Objekti: “Shërbimi i ruajtjes me roje dhe sistem alarmi” Qendres Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan – Marrëveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Sherbimit:

Numri i Vendrojeve	Numri i turneve	Numri i rojeve te nevojshme	Afati i levrimit
7(shtatë)	3 turne 24 orë cdo ditë kalendarike	34.86	12 muaj <i>Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.</i>
5(pesë) objekte sistem alarmi	16 ⁰⁰ -08 ⁰⁰ (e henë - premtë) dhe 24 orë (e shtune,dielë e ditët e festave zyrtare)	5 sisteme alarmi me aksesoret perkates	12 muaj <i>Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.</i>

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Në rast se brenda kësaj periudhe, shoqëria “Illyrian Guard” sha do të marrë përsipër ofrimin e këtij shërbimi bazuar në VKM-në nr.177, datë 4.4.2019 “Për krijimin e shoqërisë «Illyrian Guard» sha, dhe për përcaktimin e Autoritetit Publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie!” pikat 10 dhe 11, kontrata e lidhur mes Qendrës Spitalore “Xhaferr Kongoli” Elbasan dhe Operatorit Ekonomik që do të shpallet fitues në këtë procedurë prokurimi do të konsiderohet e zgjidhur nga hyrja në fuqi e kontratës me “Illyrian Guard” sha.

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Shërbimi që kërkohet Objekti: “Shërbimi i ruajtjes me roje dhe sistem alarmi” Qendres Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan – Marreveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

Parandalimi, bllokimi, bashkepunimi me autoritetet e policise se rendit ne rastet e mundshme te vjedhjeve, demtimeve e shkaterrimeve te objekteve, prones dhe te pasurise se Qendres Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan, per zbulimin dhe kapjen e autoreve.

Shperndarja:

- Sipas vendndodhjes se **Qendres Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan**

-Spitali Elbasan (Pathollogji) 1 vendroje, -Spitali Elbasan (Kirurgji-Maternitet) 1 vendroje, Poliklinika e Specialiteteve 1 vendroje, -Spitali Elbasan (Pediatria) 1 vendroje, -Spitali Elbasan (Urgjenca) 1 vendroje, -Spitali Elbasan godina adm 1 vendroje, -Spitali Elbasan (Telemjeksisa) 1 vendroje

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< Emri >

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumentat Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera _____	
<i>(me numra dhe fjalë)</i>	

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
Vlera _____	
<i>(me numra dhe fjalë)</i>	

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Dokumentat Standarde të Tenderit

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16.

**KUSHTET E PËRGJITHSHME
Shërbimet–Kërkesë për propozim**

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat

mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
